



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1541/9 prot

Datë 24.09.2021

V E N D I M
K.P.P. 672/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.09.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Mifeel” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-01371-07-21-2021, me objekt “*Materiale për mirëmbajtjen e rrjetit K.U.Z (kanaleve të ujërave të zeza)*”, me fond limit 1 250 760 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër ShA.

Ankimues: Operatori ekonomik “Mifeel” SHPK
Gjirokastër, Qyteti Gjirokastër

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër ShA
Zona Industriale, rruga Muharrem Gega

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.07.2021, është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit “Procedure e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-01371-07-21-2021, me objekt “Materiale për mirëmbajtjen e rrjetit K.U.Z (kanaleve të ujërave të zeza)”, me fond limit 1 250 760 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër ShA.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 09.08.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Mifeel” SHPK	1 111 000 lekë	skualifikuar
2. Ermal Meci p.f	1 152 292 lekë	skualifikuar
3. Ervin Luzi p.f	1 190 000 lekë	skualifikuar
4. “Start Co” SHPK	1 193 796 lekë	kualifikuar
5. “Asi 2A Co” SHPK	1 238 500 lekë	kualifikuar

II.2.1 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik “Mifeel” SHPK rezulton se është skualifikuar për arsye se:

“OE nuk ploteson piken 1,2,3 tek kriteret 2.3 Per kapacitetin teknik ne DST, pasi ka paraqitur ne SPE certifikaten ISO 9001:2015 Per sistemin e menaxhimit te cilesise por nuk ka te specifikuar objektin e prokurimit.

OE ka paraqitur ne sistem certifikaten ISO 14001:2004 Per sistemin e menaxhimit te mjedisit por nuk ka te specifikuar objektin e prokurimit.”

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezultoi se autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në dy data të ndryshme, konkretisht me 12.08.2021 dhe me datë 13.08.2021.

II.4. Në datën 16.08.2021, operatori ekonomik “Mifeel” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5 Me shkresën nr. 987/14 prot., datë 17.08.2021, protokolluar me tonën nr. 1529 prot., datë 18.08.2021, me objekt “Plotësim ankesë” autoriteti kontraktor i bën me dije Komisionit të Prokurimit Publik se: [...] *Shoqëria Ujësjetës Kanalizime Gjyrokastër SH.A konstaton se OE Mifeel SHPK me NIPT L82916601N nuk ka zbatuar nenin 111 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.*

Ankimuesi duhet t’i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

4. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementeve të sipërpërmendura ose nuk është shoqëruar me mandat pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin.

Në rast të mos korigjimit/plotësimit brenda afatit 2 ditor nga dita e njoftimit ajo vlerësohet si e paparaqitur.”

II.6. Në datën 20.08.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik me të njëjtat pretendime që ka paraqitur në autoritet kontraktor.

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1541/2 prot., datë 20.08.2021, u publikuan kriteret e kualifikimi, për të cilat operatori ekonomik “Mifeel” SHPK është skualifikuar.

II.8. Me shkresën nr. 987/17 prot., datë 23.08.2021, protokolluar me tonën nr. 1541/3 prot., 24.08.2021 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Mifeel” SHPK nga ku rezulton se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.9. Me shkresën nr.1541/4 prot., datë 27.08.2021 Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Autoritetit Kontraktor për paraqitjen e një informacioni më të hollësishëm në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.10. Me shkresën nr. 987/19 prot., datën 31.08.2021, protokolluar me tonën me nr. 1541/5 prot., datë 01.09.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i hollësishëm i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit paraparak të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Përpara shqyrtimit në themel të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Mifeel” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson të ndalet dhe të shqyrtojë respektimin e kushteve formale të ankesës nga operatori ekonomik ankimues, ku një prej të cilave është respektimi i afateve të ankimit.

III.1.1. Në nenin 4, pika 41, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, përcaktohet se:

“Sistem i prokurimit elektronik” është një bazë të dhënash shtetërore, e krijuar sipas legjislacionit në fuqi e që përdoret për kryerjen e procedurave të prokurimit publik dhe administrohet nga Agjencia e Prokurimit Publik”

Në nenin 97, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, është parashikuar se:

“1. Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.

2. Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në formë shkresore, autoriteti kontraktor publikon njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike. Me publikimin e njoftimit të fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike, operatorëve ekonomikë iu lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.”

III.1.2. Në datën 17.09.2021, me anë të shkresës nr. 1541/6 prot., Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi nga operatori ekonomik ankimues “Mifeel” SHPK, që të paraqesë pranë KPP-së, një “Printim ekrani” të mesazheve që i janë dërguar këtij të fundit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) nga autoriteti kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, si dhe çdo provë tjetër që vërteton marrjen dijeni nga ankimuesi mbi njoftimin e fituesit.

III.1.3. Operatori ekonomik ankimues “Mifeel” SHPK në përgjigje të shkresës nr. 1541/6, datë 17.09.2021 të KPP-së, ka dërguar dokumentacionin e kërkuar në postën elektronike zyrtare të

KPP-së e cila u protokollua me nr.1541/7 prot., datë 22.09.2021 si dhe përmes shërbimit postar protokolluar me tonën nr. 1541/8 prot., datë 23.09.2021. Në dokumentacion ka bashkëlidhur “Printim ekрани” të rubrikës mesazhe në llogarinë e tij në SPE, me anë të së cilës vërtetohet se nuk është njoftuar nëpërmjet SPE lidhur me njoftimin e fituesit.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik sjellë në vëmendje pikën 2 të nenit 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”. Ndërsa në formularin e njoftimit të fituesit, të publikuar në buletin nr.122, datë 16.08.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, i cili është formular standart i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe është i përfshirë në dokumentet standarte të tenderit, përcaktohet: “Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

III.1.5. Sa më sipër, bazuar në përcaktimet sipërcituara, si dhe bazuar në parashikimet ligjore në fuqi për prokurimin publik, Komisioni gjykon se në rastin konkret, përlllogaritja e afatit për të paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, nis nga dita e marrjes dijeni nga operatorët ekonomik mbi njoftimin e fituesit dhe përfundon ditën e shtatë. Komisioni thekson se për sa kohë që, operatori ekonomik “Mifeel” SHPK, nuk ka marrë dijeni nëpërmjet SPE mbi njoftimin e fituesit, si dhe për sa kohë që në formularin standart të njoftimit të fituesit, të publikuar në buletin nr.122, datë 16.08.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është përcaktuar se me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit, atëherë përlllogaritja e afateve për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, do të nisë nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit në buletin e njoftimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik. Në këto kushte, Komisioni gjykon se në rastin konkret, përlllogaritja e afatit për të paraqitur ankesë sipas nenit 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nis që nga data 16.08.2021, dhe përfundon në ditën e shtatë. Sa më sipër, ankesa e operatorit ekonomik “Mifeel” SHPK është paraqitur brenda afateve të përcaktuara në bazën ligjore të sipërcituar, e për rrjedhojë Komisioni vendosi të shqyrtojë në themel këtë ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Mifeel” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: “OE nuk ploteson pikën 1,2,3 tek kriteret 2.3 Per kapacitetin teknik ne DST, pasi ka paraqitur ne SPE certifikaten ISO 9001:2015 Per sistemin e menaxhimit te cilësisë, por nuk ka te specifikuar objektin e prokurimit. OE ka paraqitur ne sistem certifikaten ISO 14001:2004 Per sistemin e menaxhimit te mjedisit, por nuk ka te specifikuar objektin e prokurimit.” K.P.P vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 2 të dokumenteve të tenderit “Lista e çmimeve dhe artikujve” është parashikuar si më poshtë:

NR	PËRSHKRIMI MATERIALEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	SHUMA
A	Material rakorderi PVC dhe te brinjezuar				

1	<i>Tub PVC Ø 140 /6 Atm</i>	<i>ml</i>	<i>100</i>		
2	<i>Brryl Ø 100 90° PVC</i>	<i>cope</i>	<i>20</i>		
3	<i>Brryl Ø 110 45° PVC</i>	<i>cope</i>	<i>20</i>		
4	<i>Brryl Ø 100 135° PVC</i>	<i>cope</i>	<i>10</i>		
5	<i>Brryl Ø 200 135° PVC</i>	<i>cope</i>	<i>3</i>		
6	<i>Tub PVC i Brinjezuar Ø 100 6 Atm</i>	<i>ml</i>	<i>150</i>		
7	<i>Tub PVC i Brinjezuar Ø 160 6 Atm</i>	<i>ml</i>	<i>300</i>		
8	<i>Tub PVC i Brinjezuar Ø 200 6 Atm</i>	<i>ml</i>	<i>450</i>		
9	<i>Tub PVC i Brinjezuar Ø 315 6 Atm</i>	<i>ml</i>	<i>300</i>		
10	<i>Ngjites per tuba PVC 1 kg</i>	<i>cope</i>	<i>4</i>		
11	<i>Tub PVC i Brinjezuar Ø 400</i>	<i>ml</i>	<i>30</i>		
12	<i>Tub PVC i Brinjezuar Ø 500</i>	<i>ml</i>	<i>50</i>		
13	<i>Brryl i Brinjezuar Ø 315 90°</i>	<i>cope</i>	<i>5</i>		
	SHUMA 01				
B	Material Celiku dhe hekur				
14	<i>Tel celiku Ø 4 ;4.5</i>	<i>kg</i>	<i>250</i>		
15	<i>Hekur betoni Ø 10</i>	<i>kg</i>	<i>800</i>		
16	<i>Hekur betoni Ø 12</i>	<i>kg</i>	<i>500</i>		
17	<i>Gozhde druri 6</i>	<i>kg</i>	<i>10</i>		
18	<i>Gozhde druri 12</i>	<i>kg</i>	<i>10</i>		
19	<i>Tel bari per lidhje</i>	<i>kg</i>	<i>10</i>		
20	<i>Kapak pusete metalik 70 x 70 set (kapak + kornize) 5+5(te rrumbullaket)</i>	<i>cope</i>	<i>10</i>		
21	<i>Bombel per ngjitje PVC + paisje</i>	<i>cope</i>	<i>5</i>		

SHUMA 02						
C	<i>Material per punime civile</i>					
22	<i>Bllaqe betoni</i>	<i>cope</i>	<i>1000</i>			
23	<i>Drrase druri 2 cm</i>	<i>m³</i>	<i>1.25</i>			
24	<i>Plumb</i>	<i>kg</i>	<i>50</i>			
25	<i>Binare druri per kallepe 8 x 8</i>	<i>m³</i>	<i>0.5</i>			
SHUMA 03						
		SHUMA TOTALE				
		<i>TVSH 20 %</i>				
		VLERA TOTALE	LEKE			

III.2.2. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “kapaciteti teknik”, është parashikuar kriteri si më poshtë:

a) *Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015, ose i përditësuar (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO zërave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.(te kete te specifikuar objektin i prokurimit ose ekuivalent i ngjashëm)*

Certifikatën që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor ISO 14001:2015 ose i përditësuar (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes). .(te kete te specifikuar objektin i prokurimit ose ekuivalent i ngjashëm).

III.2.3. Nga verifikimi në sistemin elektronik në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “Mifeel” SHPK ka paraqitur në sistem dokumentacionin si më poshtë:

- *Certifikatë EN-ISO 9001:2015 me objekt: tregtim i mallrave dhe pajisjeve elektrike, elektronike, didaktike, laboratorit dhe industriale. Tregtimi i imputeve bujqësore. Shërbime në bujqësi dhe shërbime 3D.*
- *Certifikatë EN-ISO 14001:2015 me objekt: tregti e përgjithshme e mallrave didaktike, elektronike, laboratorike dhe industriale. Shërbime në bujqësi, dezinfektim, dezinfektim, deratizim (3D).*

III.2.4. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në nenin 79 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

Ndërsa në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.6. Në rastin konkret, referuar dosjes së tenderit, në seksionin “Të dhënat kryesore” autoriteti kontraktor ndër të tjera ka përcaktuar: “Kodi CPV :42131140-9 - Reduktues-presioni, kontroll apo valvola të sigurisë”. Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në seksionin “Të tjera”, në rubrikën “Kodet CPV” përcaktohen grupi i kodeve, emërtimi i kodit CPV dhe Identifikimi i kodit CPV për procedurat e prokurimit elektronik. Sa më sipër, në grupin e kodeve “Makineri industriale” bën pjesë emërtimi i kodit CPV:42131140-9 dhe identifikimi i kodit Reduktues-presioni, kontroll apo valvola të sigurisë , që përputhet me kodin CPV të procedurës së prokurimit dhe me objektin e veprimtarisë për të cilën janë lëshuar certifikatat EN-ISO 9001:2015 dhe EN-ISO 14001:2015 për operatorin ekonomik “Mifeel” SHPK pasi objekti i veprimtarisë së certifikatave të sipërcituara ndër të tjera përfshinë dhe tregtimin e mallrave industriale. Në këtë kuadër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues me dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit publik për përmbushjen e kriterit “a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015, ose i përditësuar (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO zërave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të

realizojë sipas akt marrëveshjes Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.(te ketë te specifikuar objektin i prokurimit ose ekuivalent i ngjashëm)) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015, ose i përditësuar (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO zërave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.(te ketë te specifikuar objektin i prokurimit ose ekuivalent i ngjashëm)

Certifikatën që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor ISO 14001:2015 ose i përditësuar (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO zërave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes). (te ketë te specifikuar objektin i prokurimit ose ekuivalent i ngjashëm” është në përputhje të plotë me kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuar në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2.7. Për arsyetimin më sipër , KPP e gjykon të pabazuar vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Mifeel” SHPK dhe ky vendim duhet anuluar si një vendim i dalë në kundërshtim me ligjin në kuptim të nenit 119 pika 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i cili parashikon se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

- a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;*
- b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;*
- c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;*
- ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;*
- d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.”.*

III.3. Gjithashtu referuar ankesës së operatorit ekonomik “Mifeel” SHPK të depozituar në KPP me nr. 1541 prot., datë 20.08.2021 ai paraqet pretendime në lidhje me juristen e autoritetit kontraktor me iniciale S.K e cila sipas tij ka ndikuar në procesin e vendimmarrjes dhe skualifikimin e operatorit ekonomik. Akoma më tej, referuar dokumentacionit të dërguar në KPP nga operatori ekonomik “Mifeel” SHPK në postën elektronike zyrtare të KPP e cila u protokollua me nr.1541/7 prot., datë 22.09.2021 si dhe përmes shërbimit postar protokolluar me tonën nr. 1541/8 prot., datë 23.09.2021., rezulton se operatori ekonomik ankimues përmes komunikimit me mesazhe me qytetaren Suada 2 paraqet sërish pretendime mbi ndikimin e saj në procesin e vendimmarrjes lidhur me procedurën në fjalë. Referuar pretendimeve të operatorit

ekonomik ankimes për qytetaren S.K të paraqitura në ankesën drejtuar KPP, shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt ankimi si dhe nga raporti i auditimit në SPE reulton se personi me inicialet S.K ka qenë anëtare e njësisë së prokurimit për procedurën e prokurimit në fjalë duke ngritur dyshime se e ka ushtruar detyrën e saj në kushtet e konfliktit të interesit në kuptim të nenit 3 pika 1 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, i cili parashikon se: *“1. “Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.”*

III.1.10. Sa më sipër bazuar në nenin 23 “Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, duke ju referuar materialeve të administruara nga operatori ekonomik ankimes “Mifeel” SHPK, KPP gjykon se duhet ti propozohet Agjencisë së Prokurimit Publik nisja e hetimit administrativ në lidhje me pretendimet për ushtrimin e detyrës në kushtet e konfliktit të interesit nga qytetarja me inicialet S.K, anëtare e Njësisë së Prokurimit në procedurën e prokurimit objekt ankimi .

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”* Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mifeel” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-01371-07-21-2021, me objekt “Materiale për mirëmbajtjen e rrjetit K.U.Z (kanaleve të ujërave të zeza)”, me fond limit 1 250 760 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër ShA.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Mifeel” SHPK duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ti propozohet Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Mifeel” SHPK.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri